



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:104254

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05294935

C.nr.562/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil, përmes gjyqtarës Florije Qerimi me bashkëpunatoren profesionale Shkurte Kadriu, në çështjen kontestimore të paditësit E. M. U. nga fshati L. i . K. e Gj., të cilin e përfaqëson Ymer Huruglica avokat nga Gjilani, kundër të paditurit E. M. U. nga fshati L. i .t, Komuna e G.t, me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë, jashtë seancës, më datë 06.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. FTOHET paditësi E. M. U. nga f.i L. i U., K. e Gj., që në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta plotësojë padinë me akt vdekjen e të ndjerit E.H. U. nga fshati L. i U., Komuan e Gj., pronar juridik i njësive kadastrale kontestuese.

II. Në rast se paditësi brenda afati të lartëcekur, nuk ia dorëzon gjykatës provat me vërejtjet si në pikën I të këtij aktvendimi, do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë, e në rast se e njëjta gjykatës i dorëzohet e pa plotësuar padia do të hidhet poshtë.

A r s y e t i m

Paditësi E. M.t U. nga fshati L. i U., K. e Gj., në këtë gjykatë përmes përfaqësuesit të tij Ymer Huruglica avokat nga Gj., ka paraqitur padi me datë 23.05.2022, kundër të paditurit E.M. Uk. nga fshati L. i U., Komuna e Gj., me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë.

Gjykata për të vendosur në mënyrë të drejtë dhe të saktë në këtë çështje juridike kontestimore dhe për të vërtetuar legjitimitetin e real pasiv të paditurit e obligon paditësin që plotësojë padinë me akt vdekjen e të ndjerit E. H. U. nga fshati L. i U., Komuna e G..

Meqë mungesa e legjitimitetit real aktiv dhe pasiv është prezumim i natyrës materialo juridike, për të cilën gjykata duhet të kujdeset ex officio gjatë gjitha fazave të procedurës, dhe meqë legjitimiteti real nënkupton detyrimisht një raport juridiko civil të palëve ndërgjyqëse për të

drejtën e tyre subjektive për të cilën është filluar kontesti, gjykata është e detyruar që të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë në mungesë të raportit juridiko civil, respektivisht të mungesës së legjitimitetit real pasiv. Andaj duke u bazuar në të dhënat e lartëcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.562/2022, me datë 06.02.2024

Gjyqtarja
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë.